

8JH-1  
H 98



Vaid Hyzoti  
Zérat  
e ditës së re  
poezi

888-1  
HSS

VAID  
HYZOTI

Zërat  
e ditës  
së re

poezi



SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

998  
89 H  
DAVID  
HYDRO

Redaktor  
FOTO. MALO

Zefot  
zätilib e  
et 52

boszi



SERBIA BOTNIK  
VAN VANASHIN

## TRËNDAFILAT

Kam në shtëpi një rrënje trëndafili  
që mbrëmjeve me shumë gonxhe e shoh,  
veç s'di kush i këput kur bie mëngjesi,  
ndoshta nëna, babai... (unë çohem më vonë!).

Ngrihem e shoh trëndafilin në portë,  
e kupton ai se ç'dua unë.

Me fëshfërimë fletësh sikur më thotë:  
«Ua dhashë atyre që shkuan në punë».

## SHTËPIA E PARTISË

Kjo më ngjan me shtëpinë time,  
dhe me tënden ngjan, natyrisht:  
një pllakë merméri mban në hyrje,  
te porta — orarin për vizitë.

Tryezës, ka një llambë vajguri,  
(të tillë kishim dhe ne dikur),  
babai në tryezë nuk e vuri,  
por mbi oxhak a te një gozhdë në mur.

Këtu u mblohdhën ata një natë nëntori  
dhe erdhën pastaj në çdo yatër...  
Kjo llambë qelqendritur flakën e mori  
nga vatra jonë dikur e varfër...

## NË TË GJITHA RRUGËT...

Edhe në rrugicat me avlli superëna,  
bulevardeve me shatërvane e trotuare të gjera,  
në rrugë të spërkatura me jargë buajsh,  
në mezhda qëndisur me thundra kuajsh,  
rrëpirave ku shkojnë vetëm tufat e dhive,  
vijave të barit çelur prej stuhive,  
pranë kullusorëve që çajnë mes parcelave,  
në hekurudhëzat e minierave,  
në institucione dhe akademira.  
në tërthore malesh e asfalte të dlira,  
në të gjitha rrugët, të moçme e të reja,  
mund të shkosh për tek atdheu.  
Dhe kur i ndien, i do të tëra,  
vetë bëhesh pjesëz e këtij dheu.

## PËR HERË TË PARË NË KRYEQYTET

S'më kujtohet në ç'moshë kam qenë,  
mbase në klasën e dytë fillore,  
kur shëtita udhëve të Tiranës  
me babanë që fort më mbante përdore.

Për herë të parë në Tiranë kisha dalë,  
njerëz të shumtë shkonin rrugës;  
Skënderbeu i hipur mbi kalë  
i qetë qëndronte ndanë Pallatit të Kultürës.

Për pallatet, shëtitoret e gjera  
e pyesja babanë hap pas hapi.  
Dinte ai, dinte për të gjitha,  
siç dija dhe unë shumë gjëra nga fshati.

Si shëtitëm tërë ditën, në darkë  
babai shpejtonte që të zinim trenin.  
I thashë: — O babë, shëtisim dhe pak,  
se mbase shikojmë xhaxhi Enverin.

1977

## R R I T J E ROTSH

Nuk duhet të vëmë duart në kokë  
e të thërrasim me të zvargurin zë  
se paskemi pasur kujtesë të fortë,  
ndërsa tani?... Medet, po na lë!

Se diçka nga fëmijëria mend s'e mbajmë,  
një fytyrë bashkudhëtari në tren.

Ah, emri i një personazhi romani  
ndër mend s'po na vjen!

Paskemi harruar ca qyfyre nga shkolla,  
hollësi si ca kleçka... kujtesa na la!  
Shokë, në vendin e kujtimeve të vogla  
lartohen si shtylla ndodhi të mëdha.

## HISTORI MIRDITE

Malet krahfutur te njëri-tjetri.  
Kullat mbi rrëpira veçonin njerëzit.

Frëngjité e vogla përgjonin errësirën,  
në emër të vdekjes dikujt i thirrën.

Plumbi i gjakmarrjes zhbironët honit  
shtyrë nga baruti i kullës së Oroshit.

Me hejbe në krah mirditori nisej  
në Prizren a Shkodër për tri qase misër.

Dhe ecte me natë, dhe ecte me ditë,  
ëpingat i griseshin në shkëmb të florintjtë.

S'e dintë thesarin që flinte nën shkrepë,  
kërkonte veç misër. (Tek misri që jetë).

Dhe cullëve të sotëm nga kjo gojëdhënë  
u kujtohet të kérkojnë bukë të bardhë.

Dhe kullat e lashta zgjeruan frëngjité,  
të marrin, të japin diell e dritë.

## K R U J A

Kështu kanë qenë  
e do të mbeten:

bashkë,  
Në prehrin e Krujës  
kështjella e lashtë;  
Kruja ankoruar  
në atë shpatmal  
dhe malet shqiptare  
vazhdim natyral.

## NË MUZEUN «GJERGJ KASTRIOTI»

Ka një zakon ciceroni i muzeut «Gjergj Kastrioti»:  
ndryshe nga ciceronët e muzeve të tjera,  
si u shpjegon vizitorëve rekuizitat, dokumentet;  
me ta del në bedenë.

Të shohin bedenët e kështjellës së rëndë,  
malet përkarshi dhe ullinjtë e lashtë...  
O, po në muze gjithçka s'futet brenda,  
historia: breza e male bashkë...

JANAR 1985

U prish bukuria e borës sivjet,  
mbrëmjeve rrugët kaq shpejt zbrazen.  
Fëmijët seriozë, pranë prindërve të vet  
po ndjekin lajmet.

Mornica të çon dëbora në ekran,  
dëbora e rënë në Kukës a Pukë.  
«Sa bukur!» tashmë për të nuk thamë,  
thamë për buldozët që hapnin rrugë.

Thamë për makinat ngarkuar më ushqime,  
për helikopterët që mjegullës çanë.  
Kryebukuria e ditës ishte  
t'u ndodhemi vëllezërve pranë.

... Dhe kur bie borë në krahinën tonë,  
pyesim ç'bëhet në Alpe a në Dibër.  
Se duam bukurinë e jetës sonë  
të mos e cënojë asnje dimër.

## N D E R I M

Si ndodhi sivjet? Askush s'e besonte,  
fshehur pranvera mbante dimrin.  
Të ftohtit s'pati kufi mardin,  
cikma erdhi me 11 prillin.

Ndodhka në natyrë, ndodhka kështu,  
stinët t'ia zënë vendin njëra-tjetërës.  
Po nuk ka ndodhur — s'do të ndodhë kurrë  
që njerëzit të ndërrojnë vendin e zemrës.

1985

## PAS VITESH

Një grup të moshuarish,  
në festën e çlirimit të Mirditës, të dielën,  
pas mitingut e koncertit festiv  
te përmendorja e Katër Heroinave erdhën.

Ata (ose moshatarët e tyre),  
në fillim s'e dinin pse luftonin cuçat.  
Për cuçat në fillim ata s'folën mirë.  
Pastaj... pështynë cubat.

Tani, mbi atë pendesë  
thérresin fotografët:  
Kujdës,  
të Katra me ne të dalin!

## PËRNGJASIM

Ksamili-gonxhe e hapur ballë detit,  
sa ngjan me qytetin tonë të studentit!

Godinat e bardha pranë e pranë  
si qyteti ynë mbi një kodër në Tiranë.

Nga gjiri i blerimit vijnë jone këngë,  
thua se studentët sonte paskan mbrëmje...

Ksamili—gonxhe e hapur ballë detit,  
sa ngjan me qytetin tonë të studentit!

Por ne kemi mimoza, si ëndrrat e bukura.  
Ksamili ëndrrat i shpërtheu në fruta...

## KANDIDAT PËR BUROKRAT

Sa qemë studentë, nuk e kuptuam  
kë kishe inat, kë më shumë doje.  
Fjalën e ëmbël ruaje për të gjithë,  
për të gjithë—buzëqeshjen njëlloj.

Për pedagogët—i sjellshëm, «fisnik»,  
në kafe paguaje. (Gjuaje rastet).  
Gjithë etiketë, (jo servili klasik,  
që i mban profesorit çantën).

Mbaruan studimet. Të vajti mbarë;  
për ty instituti e gjeti një vend.  
E dimë se shumë kohë më parë  
i ke buzëqeshur ti fatit tënd.

«I urtë... I dashur... punëtor dhe notat...»,  
karakteristika-shkallë drëjt karrierës.  
Veç shkallët e saj s'qenë të betonta,  
me sfungjer lajkash ishin ngritur në erë.

## RRETH DASHURISË

Ndaj sot s'habitema që në gazetë  
si burokrat kritikohesh tifl (është e  
Se burokrat i ardhshëm mund të jetë  
dhe një servil ende pa përgjegjësi.



## RRETH DASHURISE

Jam zemërlenduar, spadyshim, që do t'ju  
që ne u ndamë (dhe më mëri) i përmes  
Veç do isha vrapë shumëfish i tjerët, që  
sikur të zgjelltitesha, përsëri. Nivona është

Mrekullohesha kur të kisha pranë:

«Sa flokë të butë! Eh, ç'sy si qelqe!...».

Dhe nuk pyesa:

nënën e babanë

pse s'i bënë sytë tu për vete?

S'duhej të josheshë e dehesha  
nga aromë e rrallë e zërit tënd,  
por të kuptoja se pas fjalëve që thoshe  
fshihej edhe fyterja e rëndë.

Më hutove me sytë, zërin, hiret,  
dashurove emërimin tim në Tiranë.

Dhe s'e peshove dashurinë e dëlirë  
që kisha për vendlindjen, nënën, babanë...

## NJOH NJE NJERI...

Njoh një njeri, njoh një komshi,  
që s'do në rrugë të piqemi bashkë.  
Ai gjithnjë më ngjall bezdi  
me atë ecje të ngadalte.

Gjithnjë në një orë shkon ai në punë,  
në një orë gjithnjë kthehet nga puna,  
kurre të nxehet nuک e pashë unë,  
lulen e buzëqeshjes  
kurre s'ia pashë te buza.

Thonë se në uzinë punon mire  
dhe me shokët është korrekt,  
veç si privati i dikurshëm  
ai sheh «hesapin e vet».

Hesapin e vet!  
Unë njoh një njeri, këtë komshi,  
qenie të qetë, pa nerva fare.  
Unë njoh një njeri, një jabanxhi  
në kohën tonë të madhe.

## NË PROVIMIN E EKONOMISË POLITIKE

Fëmijët e hyrjes sime  
zhurmë më nuk bëjnë,  
që unë jam me provime  
se kush u ka thënë.

Dhe partizanen-luftë  
e bëjnë disi heshtur,  
pa krisma të forta, zhurmë,  
pa kukurismë-të qeshur.

E unë operoj thellë  
mbi imperializmin,  
luftërat kush i sjell,  
mbivlerën, fitimin.

Si ecëm ne kështu  
me plane pesëvjeçarë,  
si erdhëm gjer këtu,  
më tej si duhet çarë.

## I 29 T R A P

Dhe nesér po më thanë  
fémijét c'notë mora!  
kurrë pushkën partizane  
mos ta lëshojmë nga dora!

1979

## Q A R T E S I

U tregoj a nxënësve të mi  
se sì një turist para një kishe  
deshi të dinte orën për meshën;  
dhe s'u habita-ishtë e natyrshme,  
nxënësit me të madhe qeshën.

8781

## SHOH NJË FËMIJË TË THOSH

Shoh një fëmijë që nqeshën  
e prej gëzimit doqkat il-pëplas.

Në buzë e tij, që pësodetet  
në gropat hatte, faqeve, tjetra që  
sa gaz!

Shoh një fëmijë që qeshet  
dhe asgjë tjetër nuk i shoh përqark!

është më i madhi që

# ESHTE E NATA YRSHEME?

Eshtë e natyrshme që qelli hedh dëborë, si për t'u shprehur malevet qiltërsinë e tij. Eshtë e natyrshme që dhelzne, spadashur, bës duke doztarime dëborë, por edhe të bëhemë fëmijë.

## ENDRRAAT

Motra imé, sa njëkukullne vogël, nle  
fle e buzëqesh në gjumë. E c'endrra vallë zajo mund të shohë? Mbës  
Mbës të rrjët në këmbë si dhet unë.

Kështu nisin të gjitha enderrimet: në fillim të rrjmë mbi këmbët tonë, i sq  
pastaj zgjatim duart të prekim, celësin dritës qëllardhori.

Endrrat rriten e marrin krahë ahore kur rritemi dhei jetë. Kur më duart tonë montojmë dhei ndezim  
të gjitha dritat në jetë.

Spill ejet ejet ob jeta ejet  
mëndësi lindësë s' është  
spill ejet ob jeta ejet

## FËMIJET TANË

Kanë nevøjë për dashurinë tonë,  
nevojë këmí për dashurinë e tyre,  
si të rritur rrinë seriozë,  
ndërsa ne bëjmë pëtë trille fëmije.

Shkrin shpejt inati fémínor  
nëse s'u japim p.sh. çokollatën.  
Veç mos u shuaj televizorin  
mbrëmjeve, tek ndjekin përrallën.

## 17. MARS 1924

C'te më sillni për festë nxënësit  
s'e patën menduar me njëri-tjetrin,  
Kur hyra në klasë, seç po flisnin  
e sytë u geshnin.

E pasi heshtën tok një grimë,  
u ngrit një vajzë, në bankë të tretë:  
Mësues, të bëjmë sot hartim  
e temën ta zgjedhim, vetë?

Ariv, ushtrit, që nuk nuk  
nuk nuk nuk nuk nuk nuk nuk  
nuk nuk nuk nuk nuk nuk nuk nuk  
nuk nuk nuk nuk nuk nuk nuk nuk

Uzit, uzit, uzit, uzit, uzit, uzit,  
uzit, uzit, uzit, uzit, uzit, uzit,  
uzit, uzit, uzit, uzit, uzit, uzit,  
uzit, uzit, uzit, uzit, uzit, uzit,

## FESTË FAMILJARE

Uromëni, uromëni, o'shokët e mi:  
unë sonte u bëra me motër, ne sone  
ne sonte u bëmë pesë fëmijë,  
«U shtua dhe një lugë në sofër».

Një ditë dhëajon vëtë do të flasë:  
e një ditë kjo motër do të qëshë,  
mbase do të bëhet më arsimatë lartë,  
mbase punëtore, mbase bujkeshië!

Tani emër ende s'i kanë vënë,  
për mua tash quhet vetëm motër.  
Një ditë ajo në këto rrugë do të ecë  
duke menduar për botën.

Sonte në shtëpi kemi festë intime,  
se u bëmë pesë fëmijë!  
Ejani uroni nënën time  
që tani i jep foshnjës të pijë...

1976

## 16 VJECUM

Me tē puthurëh e saj nē cép tē bülzëve, fershelleja,  
si tē kisha ëbririn ne hënës më vete.  
Por pëllëmbë e bâbait më priste në shëpi, kur erdha,  
se isha vonë. Më merrija rrugë tē keqë!

Tek e puthura pranët është ob këpib ëp ib k  
m'u ndez dhe shaplekët; është ob këpib fësjezë  
fëmijë - për bâbancë, njëjori është tash  
të rritur mëri vajza!

Ç'do tē thoshte vallë sonte im atë  
tē dinte se nën qepalla  
fshihja një vajzë?

## N J E D I T E

Shpesh sy më sy shihemi bashkë  
e njëherësh vështësimin ulim në tokë.  
Shpesh pënjemi pranë e pranë  
e një fjale njëri-tjetrit s'i themi dot,

E di që diçka do të të them një dité,  
patjetër diçka do më thuash mua,  
tani më duket se drojtja në botë  
u krijua për njerëzit e sapodashuruar.

## TAKIMI I PARË

Ku bashkohet Drini me Valbonën,  
u takuam edhe ne të dy.  
Dallgë Drini gjoksin ma trazonin,  
ti Valbonën kishe në sy.

Drejt shokëve zënë përdore  
shkuam mes dritave të kantierit.  
Ashtu si Drini me Valbonën  
në një shtrat shkojnë drejt detit.

## MË MORI MALLI ::

Më mori malli për Tiranën  
dhe erdha me vrapin e trenit,  
se kam një udhëz të dashur  
këtu, në qytetin e studentit.

Kam një mimozë te liqeni,  
(«unë lulet veç për ty i ruaj»),  
e kam dy sy që më presin  
dhe s'do më bëhen kurrë të huaj.

... Po në shtëpi më priste motra,  
që më pa si e habitur:  
Ku ishe, vallë, që erdhe vonë?  
Gjithë mbasditen kemi pritur.

Ku isha? Isha larg dhe pranë,  
nisa t'i them asaj dhe quesha:  
pak punë kisha në Tiranë  
për një vëllim me vjersha.

## NË PRAG TË DASMËS

Ja, erdhi dasma!  
Në floktore  
Po shkon ti, moj Flutura.  
Si nuse, edhe flokët u dashka  
t'i bësh sa më të bukura.

Vetullat duhet t'i heqësh pakëz,  
duhen... ca gjëra që s'janë për ne;  
veçse të lutem, të lutem, e dashur,  
gërshetin mës e pre!

Pa kujto mbrëmjet e kaltra  
në vitet e fëmijërisë  
dhe ne çamarrokët e lagjes  
në lojën «Kryengritës».

Të kujtohet? Komandante të donim  
Dhe sa herë na zunë prita!  
Por gjithnjë e gjithnjë fitonim,  
se ishe për ne Shote Galica.

**Kujtohu...** tek rendje faqeskuqur,  
me bishtalecat lehtë lozte era.  
... Shkuan vitet. U rritëm, moj Flutur,  
në një breg të dy na nxori jeta.

Ndaj i thuaj të ta ruajë gërshtetin  
shoqes që punon në floktari.  
Ai nuses nuk ia prish «lezetin»,  
sjell te ne të shtrenjtën fëmijëri.

## TË KAM NË KRAH

Të kam në krah e për një çast  
të pëshpëris: e kujt je ti?  
Zëri yt — i bukuri fllad,  
sikur ma kthen: hej, ç'marrëzi! . . .

Ashtu. . . Por mua m'u fanit  
një mbles, porsi një re në muzg,  
shtëpisë sate iu avit,  
të mbyllë vajzërinë në burg. . .

Babai atij fjalën ia dha,  
tek sytë e nënës djeg një lot,  
të hidhet motra ty në krah,  
fëmijërisht të shtrëngon fort.

Unaza gishtin keq ta vret,  
tëngrirë zogjtë në qëndismë  
e krushku, pas kanunit, pret  
e në kobure fle një krismë. . .

ПО УНЕ ЕРЕРАТ  
Po unë erërat do t'i ngre  
përdhe të bjerë ai duvak!  
... Sa vite shkuan, imja je;  
në krah të mbaj e rendim larg...

# S I M O T Ě R

Shpesh harron nëna jonë  
dhe nuses me emrin e motrës i thërret.  
Ndoshta e ndien (zemra ia don)  
veç emri t'i ndryshojë prej bijës së vet.

## E FEJUARA E DETARIT

Deti, me dëshirën të na ndodhet pranë,  
vrapon drejt nesh, valë-valë, i paanë.

Për ditët e verës në të bukurin breg  
vajzën e dashruar tani malli e djeg.

Dhe valët i duken trëndafilë të bardhë  
që ia çon i dashuri i saj.

## CAST

Sapo kaloi në rrugë  
një kamion plot me ushtarë  
dhe një makinë me krushq  
me një nuse të bardhë.

Mendova: ushtarët marshojnë,  
që gjithnjë në vendin tim  
të dielat e nusebardhave  
të mos kenë kurrë mbarim.

## B A R D H È S I

Në qytetin bregdetar e presim dëborën,  
ndoshta pse e kemi mysafire të rrallë.  
Dhe për një çast të gjithë banorët  
edhe detin e duam të bardhë.

## NË T H E T H

14 mëngjese na freskoi të gjithëve  
uji i ftohtë në Theth.

14 ditë mushkëritë thithën  
ajrin e shëndetshëm në Theth.

Në të skuqurën e faqeve —  
shëndeti i maleve

përreth.

Si shkuan ditët kaq shpejt?

Mirupafshim, Theth!

## NË LUKOVË

Gjithnjë blerimmbuluar do mbeten këto brigje,  
jo vetëm nga veti e portokalleve, ullinjve;  
por pse të gjithë ata që këtu djersitën  
u dhanë nga pigmenti i pranverës së tyre.

## NË BICAJ TË KUKËSIT

Bicaj-fshati i gruas sime.

Këtu më vjen të flas lumjançe  
e pyes për grurin dhe pér delet.  
Sikur prej vitesh e njoh këtë qiel,  
që aty qeshet, aty vrenjtet.

Dhe pranë fiseve të fshatit  
mbiemrin tim përqas me mendje.  
Dhe fshati im në fushë, breg detit  
një çast këtu përreth më gjendet.

Bicaj është pranë vendlindjes sime.

## BERATI

S'mjaftojnë filma e shirita pa fund  
me vete ta marr, me vete ta kem.  
Gurë tē tillë s'do kërkoj gjékund,  
se s'ka si nē lagjen Mangalem.

Asnjë qytet nē botë s'e ka  
një shall tē tillë si Osumi.  
Fokusi duhet dhjetë herë më i madh  
për tē marrë xhaminë e Plumbit.

Dhe më i madh me qindra herë  
tē nxjerrësh ndértesat e reja;  
veç nē kalofsh një mijë dritare,  
mundet tē ngjitesh te kështjella.

Nga bukuria marramendëse  
mund tē rrëzohesh, tē vritesh pak,  
Ruaje këtë gjurmëz tē bukur  
kujtim nga qyteti Berat.

## M A L L

Ditë e zakonshme. Një plak në asfalt.  
Fillim korriku. Mesditë ishte.  
T'i fshihej diellit atë çast,  
u fut dhe u shtri në lulishte.

Kokën mbështeti. U bë si dyshek  
bari i dendur, i butë, i gjelbër.  
Një pemë e mbuloi me hijen e vet.  
Dremiti pak, sa pa një ëndërr.

Kish vite që banonte në qytet,  
shtëpinë e kishte aty, në pallat.  
Po ç'pa një ëndërr në atë kënd të qetë:  
u çmall me livadhet e kalfra në fshat...

## T E B U R I M I

Shpeshherë studentët grinden,  
kur flasin për vendlindjen e tyre  
e ia përshkruajnë me ngjyra poetike  
njerëzit, zakonet, natyrën.

Ç'mrekulli është Riviera e kaltër  
mbushur me brezare,  
ndërsa Saranda-një drapër i artë  
që pret kreshtat e valëve!

Ku ka si malet, flet tjetri më tej,  
malet shëndetplotë e vështrimrreptë?  
Në gjirin e tyre pijnë e shkëlqejnë  
Vadejë, Fierzë, Shkopet...

Kështu bëhen vetiu poetë,  
buron secili më të bukurat fjalë.  
Nuk bëjnë dallim për fshat a qytet.  
Malli për vendlindjen i ka marrë.

## I S H M I

Ishmi ka një pyll të dendur  
që gjëmonte në furtunë.

Pranë lumë e det janë gjendur,  
not në ta mësoja unë.

Një kala me mure e myshke,  
në frengji një pushkë druri.  
Gdhendur emri në një pishë  
me një cep të mprehtë guri.

Eshtë dhe një plak i ngrysur  
që gjithnjë tymos me llullë,  
dhe një grua bërë shtrigë,  
se të shoqin mbyti në kullë.

Ka ca shegë pranë teqesë,  
që kurrkush s'duhet t'i prekë.  
Veç një djalë me ca shokë  
t'i shijojë e gjen një shteg.

Gjyshemirat në sofate  
lesh të bardhë tjerrin me drugë  
dhe gojëdhëna portë më portë,  
thashetheme rrugë më rrugë.

Vjen dhe një bari i qeshur,  
gjithë fëmijët merr me vete.  
I mëson të fërshëllejnë  
dhe me pipëza, dhe me gjethe.

Ishmi ka fëmijërinë time  
në shtëpitë që ngjiten kodrës.  
Dhe për kaq atë e quaj  
fshatin më të mirë të botës.

## «RIVRASJA» E ÇERCIZ TOPULLIT

Vallë Çeçoja ç'u thotë  
njerëzve në shesh?  
Njérën luftë kujton sot  
dhe tjetrën e sheh.

S'është Çerçizi partizan,  
që lufton në mal.  
Rri mbi shesh ky kapedan,  
s'fshihet ilegal.

Mos e ditke ti, fashist,  
ç'thotë ky monument!  
Ndezka zjarrin e lirisë,  
«rroknji armët», thërret.

E fashisti armën ngre,  
bronzin e qëllon.  
Lind dhe një dëshmi e re  
e qëndresës sonë!

## V AJZA E V JEVE

Nëna nuk ta prishi qejfin,  
ta mësoi, moj vajzë, gjergjefin.

Pa mësove të qëndisje,  
yjet maleve t'i nisje...

Nëpër netët ilegale —  
yje trimave në male.

Nëpër ditë e nëpër netë  
mbete yll edhe ti vetë.

## ERDHI TETORI . . .

Erdhi tatori . . .

Dhe Shqipëria

ka ditëlindjen e Djalit.

Vetëm një çast dora na dridhet:

Kujt t'la nisim telegramin?

Erdhi tatori . . .

Data gjashtëmbëdhjetë

në mes të muajit rri.

Ashtu lartohej Enveri vetë

tek jeta jonë

në përjetësi . . .

Erdhi tatori . . .

Në mal shkruajmë prapë

emrin e Enverit të ndritur si dielli.

Fjalët që bartin urimin e bardhë

brezave malet e lartë u përcjellin.

## NATË ME SHI

Shkrepri qelli një blic vetëtime  
dhe gjëmimi vazhdoi gjatë.  
Vendin ku do të mbillte shiun  
desh të shihte për një çast.

## MES MALESH NË DIMËR

Rrugët, pemët, çatitë  
nën peshën e rëndë të dëborës.  
Dhe ti hutohesh e trishton  
se ndien mallin e tokës.

Rrezohet një ortek me bujë,  
flokët t'i ngjeth era.  
Edhe një çast kujton sikur  
prapë nuk do të vijë vera.

Por ndiqi këto gjurmë mbi borë,  
mbi akullin kallkan,  
se të çojnë në kulla malësore,  
ku dyert hapur janë.

Të çojnë ato te motosharra,  
të çojnë te miniera,  
mes malësorëve më pak ftoh bora,  
më pak e hidhur është era.

Edhe do të kuptosh patjetër  
nga fjala dhe drita e syve,  
se edhe malet s'janë gjë tjeter  
veç shembellim i tyre.

## PËRCJELLJA É VETERANIT

Për në varrezat e qytetit  
një veteran përcollën.  
Se si e bartën dhimbjen njerëzit,  
u vrenjtën, u përlotën.

Një plumb në luftë mund ta merrte  
kur ai ishte partizan.  
Dëshmor do quhej e do mbetej,  
s'do quhej veteran.

Dhe do të pushonte përjetësisht  
te lapidari, përmbi kodër;  
kjo s'do të thotë kurrsesi  
se sot atë e ndanë nga shokët.

Po do të thotë që çdo 5 Maj  
lule mbi varr t'i çojmë ne.  
Se mbeti ai një partizan,  
ushtar i kohës sonë të re!

## BUROKRATI NË PENSION

Tërë jetën mësuar në karrige,  
nga vartësit priste një «si urdhëro!»,  
kuptohet: tash të vështirë e kishte  
të ulej lulishtes në domino.

Vulosi shkresa, bëri formularë,  
(thamë: qe marrë me punë zyre),  
ndërsa tani pleqtë s'e pranojnë  
as si arbitër të lojës së tyre.

## NË VEND TË PËRGJIGJES

*Yllit, nipit tim*

Tek vendos lajm-vdekjen tënde, vogëlush,  
më hedhin dhjetëra njerëz vështrim ngushëllues.

Si t'i përgjigjem  
vështrimit të tyre?  
Në vete mund të më sjellë  
një e qarë fëmije.

## NË BIBLIOTEKËN KOMBËTARE

Dhjetëra njerëz me çanta të rënda,  
me vepra, studime, projekte...  
Seriozë, të akullt, me ëndrra,  
shkruajnë e flasin me vete.

Veprat e Enverit në «armaturë» ndrijnë,  
enciklopeditë çelin gjirin.  
Njëri i kërrusur mbi diapositivë  
lashtësisë i bën deshifrimin...

Dikush lexon mbi pirustët e lashtë,  
një tjetër letërsinë arbëreshe...  
Bori e makinës së urgjencës që jashtë  
hyri, u çoi të gjithëve kokën njëherësh.

Pastaj përkulen prapë përmbi fletë,  
në fletët që një copëz Shqipërie kanë.  
Një vjershë për mimoza. Një projekt.  
Tym lufte në skenarin e tavolinës pranë.

Biblioteka u mbyll. Nën neone  
dalin prej sallës projekte, skenare...  
E s'mbyllen vetëm në sallat komode  
përmasat e Bibliotekës Kombëtare.

## DITA JONË

1.

Me një mijë zëra  
dita e re na thërret,  
hyjnë tek ne zhurmat e udhës...  
Çdo ditë ka ftyrën e vet,  
ftyrën e njerëzve,  
ftyrën e punës.

2.

I duhemit ditës për një përshëndetje,  
për dy pikat djersë të ndershme,  
një ëndërrim,  
një përqafim;  
me buzagazin tonë  
dita të ngjeshet.

Dhe dita rrjedh si lavë çeliku  
atje ku ne i hapim brazdë.

Dhe herë e qeshur,  
herë nazike,  
e fortë si lis,  
e butë si vajzë.

Dhe dita ka kominoshet punëtore,  
ka rrezëllim metali.

Dita përbaltet ugareve tonë,  
djersin,  
freskohet tek një burim mali.

3.

Njerëz që mbylleni  
në zyrë a kafe,  
ditën tonë të re  
s'e takoni fare.

Ju, që kohën endni  
në rrjetë thashethemesh,  
dita jonë ju fshikallon,  
lëkurën ua skuq  
me rreze.

4.

Ne jemi dita,  
ne iemijeta,

në jemi drita.  
Ne që shpesh  
s'përgjigjemi dot,  
kur na pyesin:  
**ku** ishit sot?

Se në një ditë  
shëtisim atdheun  
dhe mbarë globin.  
Edhe kur qeshim,  
dhe kur brengosemi,  
në sytë tanë  
ne mbajmë botën.

Dita ka diell,  
koha ka re, —  
në sytë e kthjellët  
brengë dhe hare!

## 5.

E zbardhet dita nga zérat tanë  
e ne në sy shikojmë njëri-tjetrin,  
kur flasim për koncertin e pranverës  
e deri për çështje të mëdha të shtetit.

6.

Çdo ditë ka ngjyrat e saj,  
çdo ditë nga tjetra ndryshon.  
Ja, sot 10 shkurt  
'86  
një hekurudhë na shpalos,  
një aksion.

Me flamur

    të parat  
        koha jonë  
nisi prapë Katër Heroinat.  
Dhe me këngën «Djersët të kullojnë»  
ngrihet kënga e re:  
«ku shtrohen shinat. . .»

7.

E jona është dita,  
dritë e saj ne jemi.  
me një mijë dëshira  
e thirrje sirene  
brufullon mëngjesi

i çdo dite që presim!

## PËRMBAJTJA

Trëndafilat .....	3
Shtëpia e Partisë .....	4
Në të gjitha rrugët... .	5
Për herë të parë në kryeqytet .....	6
Rritje .....	7
Histori Mirdite .....	8
Kruja .....	10
Në muzeun «Gjergj Kastrioti» .....	11
Janar 1985 .....	12
Nderim .....	13
Pas vitesh .....	14
Përngjasim .....	15
Kandidat për burokrat .....	16
Rreth dashurisë .....	18
Njoh një njeri... .	19
Në provimin e ekonomisë politike .....	20
Qartësi .....	22
Shoh një fëmijë... .	23
Eshtë e natyrshme... .	24
Endrrat .....	25
Ekran .....	26

Duke nxituar...	27
Fëmijët tanë	28
7 mars	29
Festë familjare	30
16 vjeç	31
Një ditë	32
Takimi i parë	33
Më mori malli...	34
Në prag të dasmës	35
Të kam në krah	37
Si motër	39
E fejuara e detarit	40
Çast	41
Bardhësi	42
Në Theth	43
Në Lukovë	44
Në Bicaj të Kukësit	45
Berati	46
Mall	47
Te burimi	48
Ishmi	49
«Rivrasja» e Çerciz Topullit	51
Vajza e yjeve	52
Erdhi tetori	53
Natë me shi	54
Mes malesh në dimër	55
Përcjellja e veteranit	57
Eurokrati në pension	58
Në vend të përgjigjes	59
Në Bibliotekën Kombëtare	60
Dita jonë	62

Hyzoti, V.  
Zërat e ditës së re. Poezi. [Red.: F. Malo]  
T., «Naim Frashëri», 1986.

... f.

(B.m.) dhe

(B.v.): 891.983-1

■ 98

Recensentë:

Bujar Skendaj,  
Razi Brahimi,  
Roland Gjoza

Tirazhi 1000 kopje

Formati 70x100/32

Stash 2204-82

Shtypur: Kombinati Poligrafik  
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1986